

AKT THEMELIMI DHE STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Albanie 360" sh.p.k.

KREU I
EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHEZGJATJA
Neni 1
EMERTIMI

Duke u bazuar ne ligjin me Nr .9901 date 14.04.2008" Per shoqerite tregtare dhe ne ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 per Q.K.R te ndryshuar , me vullnetin e tije te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e ketij akt themelimi dhe statuti, sot me dt. 16/10/2019, ortaku i vetem i shoqerise "**Albanie 360**" shpk Z Vangjel Dimroçi iidentifikuar me karte identiteti me NR G91001058G vendosi

Te themelojne shoqerine "**Albanie 360**" sh.p.k dhe te shkruajne statutin per shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "**Albanie 360**" sh.p.k.

Neni 2

Shoqeria "**Albanie 360**" sh.p.k gjendet ne Tirane ne adresen " Rruga besim Imami Nr 105 Tirane" Tirane dhe mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 3

Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me statutin e saj, ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Shoqeria mund te krijojte filial ne vende ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

Neni 4

LIBRI I SHOQERISE

Per te precizuar e per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marredheniet e punes, shoqeria do te cele librin e vet, i cili do te quhet libri i shoqerise.

Neni 5

KONFIDENCIALITETI

Ortakët, si dhe personat e tjere te pranuar ne shoqeri, bien dakord qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidh, si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhme e saj,perveqse kur percaktohet ndryshe nga ligji ne fuqi.



Neni 6

Te gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretet, si: letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e ndryshme etj, duhet të tregojnë lexueshem: emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët- shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ose inçialet-sh.p.k dhe emrin e administratorit.

Neni 7

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj “ Operator turistik, promovim, organizim dhe shitje të paketave turistike brenda dhe jashtë Shqipërisë, bashkëpunim me kompani të tjera turistike dhe shitje direkte të paketave tek personat fizikë, juridikë dhe individëve” .

Neni 8

KOHEZGJATJA

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jetë 5 (pese) vjet por mund të rishikohet në raport me performancën e kompanisë.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Albanie 360” sh.p.k është 100,000 (njëqind mijë) leke. Ky kapital është teresisht i nënshkruar dhe i paguar nga ortakët I vetëm Z Vangjel Dimroçi i identifikuar me kartë identiteti me NR G91001058G. Shoqëria është e përbërë nga një kuotë. Kjo kuotë ka 100% të kapitalit të shoqërisë që përkon edhe me kapitalin e ortakut të vetëm. Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 9

Lënia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit:

Kapitali themeltar është lirishit i transferueshem tek personat e tretë, n.q.s Asambleja e ortakëve e miraton këtë vendim.

Neni 10

Asambleja e Ortakëve, miraton llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabel brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, merr vendim për ndryshimet që mund të pësojë statuti, për ndryshimin e masës së kapitalit themeltar dhe shëndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër, për pënesimin e punonjësve dhe pagat, si dhe probleme të tjera të lidhura me pënesimin në zbatim të legjislativit shqiptar etj. Vendimet e Asamblesë së ortakëve evidentohen në një regjistër të posaqem.

Neni 11

ORGANET DREJTUESE

Organi vendimmarres i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Albanie 360" sh.p.k. eshte Asamblea e Ortakeve te shoqerise, e cila zgjedh administratorin qe do te hyjne ne marrdhenie me te tretet. Administratori qe perkon edhe me daten e themelimit te ketij subjekti eshte Znj Fiona Tako e identifikuar me Karte Identiteti me NR J15125053A e cila do beje edhe regjistrimin e subjektit per here te pare, pasi eshte firmosur nga ortaku i vetem.

Neni 12

Shoqeria, drejtohet nga administratorja , nje funksion qe kryhet nga Znj Fiona Tako e identifikuar me Karte Identiteti me NR J15125053A te ciles i atribuohen te gjitha kompetencat , pervec atyre te cilat ligji ja njeh shprehimisht Asamblese se Ortakeve.

Neni 13

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe:Librin e shoqerise ne te cilin shenohet: Emrat e Ortakeve, kapitali themeltar si dhe vendimet e Asamblese.

Neni 14

PUNESIMET NE SHOQERI

Per punonjesit qe do te punesohen, marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen me kontraten e punes ne perputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punes.

Neni 15

Shoqeria merr persiper te derdh rregullisht te gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese sipas ligjit. Cdo urdherpagese e nxjerre nga shoqeria per te tretet duhet te jete e firmosur nga ortaku.

Neni 16

BILANCI

Shoqeria eshte e detyruar te dorezoje bilancin brenda afateve te caktuara ne ligjin mbi kontabilitetin.

Neni 17

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Ortakeve ose kur ka nje prishje te parakoheshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

Neni 18

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimi qe ne momentin e prishjesh se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Asamblea e Ortakeve cakton nje likujdator, te cilet I paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimi dhe mbi

afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit, Asamblea e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit. Pas pagimit te likujdatoreve, Asamblea e Ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit nese ka.

Neni 19
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Te gjithë mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit, do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.


Neni 20
DISPOZITAT E FUNDIT

Ky statut u hartua ne tre kopje ne gjuhen Shqipe, duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore.

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, ne rast mosmarrveshjes do te zbatohen normat perkatese juridike dhe Kodi Civil i Republikes se Shqiperise qe eshte ne fuqi.


Ortaku i vetem

Vangjel Dimroçi



Administratore

Fiona Tako



Tirane me 16/10/2019

Rruga Besim Imami Nr 105 Tirane